





Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020

Mars, 2016

Ky dokument është përgatitur në emër të Qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe ministritë e linjës në konsultim të ngushtë me përfaqësues të organizatave të të drejtave të njeriut dhe organizatave jo fitimprurëse të LGBTI-ve, si dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare që punojnë me çështje të të drejtave të njeriut dhe barazisë në Shqipëri.

Ekspertizë dhe asistencë teknike për përgatitjen dhe zbatimin e një Plani të ri Kombëtar Veprimi për përmirësimin e cilësisë së jetës për personat LGBTI në Shqipëri është ofruar nga Njësia e Orientimit Seksual dhe Identitetit Gjinor e Këshillit të Evropës (SOGI), përmes angazhimit të një konsulenteje ndërkombëtare për të punuar me Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, bazuar

në përvojën e punëve të mëparshme dhe në konsultim të ngushtë me ministri të tjera të linjës, organe dhe agjenci përkatëse, përfshirë dhe aktorët kryesorë të shoqërisë civile të angazhuar në

këtë fushë.

TABELA E PËRMBAJTJES

LIST	A E SHKURTIMEVE	4
Ī.	HYRJE	E
11.	SITUATA AKTUALE	7
III.	METODOLOGJIA	11
IV.	VIZIONI DHE QËLLIMET STRATEGJIKE	12
V.	OBJEKTIVAT SPECIFIKE DHE PRODUKTET MADHORE	14
VI.	BURIMET FINANCIARE	17
VII.	LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE	20
VIII.	BIBLIOGRAFIA	22
IX.	SHTOJCA 1: PLANI KOMBETAR I VEPRIMIT	23
Χ.	SHTOJCA 2: TREGUESIT E MONITORIMIT	48
XI.	SHTOJCA 3: FJALORTH I TERMAVE	50
XII.	SHTOJCA 4.1: BUXHETI NË VITE DHE SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT	52
XIII.	SHTOJCA 4.2: BUXHETI I DETAJUAR	58
ΧIV	SHTO ICA 4.3: SHPENZIME TË DETA ILIARA PËR AKTIVITETET	67

LISTA E SHKURTIMEVE

AP Avokati i Popullit
AS Akademia e Sigurisë
BE Bashkimi Evropian

DPSBGJ Dreitoria e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore

DAR Drejtoria Arsimore Rajonale
DRSH Drejtora Rajonale e Shëndetit

DRSHP Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik

DPSH Drejtoria e Policisë së Shtetit

DRFP Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional
GKZK Grupi Kombëtar i Zbatimit dhe Koordinimit
IEVP Instituti i Ekzekutimit te Veprave Penale

ILGA International Lesbian, Gay, Bisexual, Trans and Intersex Association INSTAT Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë (Instituti i Statistikave)

IP Inspektoriati i Punës
ISHP Instituti i Shëndetit Publik
IZHA Instituti i Zhvillimit të Arsimit

KMD Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

KE Komisioni Evropian

LGBTI Lezbike, Gei, Biseksualë, Trasngjinorë, Interseksualë (me dy sekse)

MPJ Ministria e Punëve të Jashtme

MF Ministria e Financave MSH Ministria e Shëndetësisë

MPB Ministria e Punëve të Brendshme

MD Ministria e Drejtësisë

MAS Ministria e Arsimit dhe Sporteve

MMSR Ministria e Mirëgenies Sociale dhe Rinisë

MZHU Ministria e Zhvillimit Urban
OJF Organizatë jo-fitimprurëse

OIIE Organizata "Intersex International Europe"
OSIGi Orjentimi Seksual dhe Identiteti Gjinor

PKV Plani Kombëtar i Veprimit

QKEV Qendra Kombetare e Edukimit në Vazhdim

QS Qendrat Spitalore

VKM Vendim i Këshillit të Ministrave SHKP Shërbimi Kombëtar i Punësimit SHSSH Shërbimi Social Shtetëror

SHSHAP Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

TGEU TransGender EU ZA Zyra Arsimore ZP Zyrat e Punës

I. HYRJE

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë është një dokument i hartuar nga Qeveria Shqiptare nën koordinimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Ky Plan është një angazhim i ri me kohështrirje 2016-2020, i cili përcakton drejtimet kyçe në fushat e legjislacionit dhe zhvillimit të politikave, sigurinë dhe mbrojtjen e të drejtave si dhe aksesin në shërbime.

Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit duhet të kuptohet si një proces dinamik ndryshimesh, i cili parashikon synime realiste, rezultate të arritshme, tregues të matshëm, alokime buxheti dhe afate kohore të përcaktuara për gjithë periudhën e zbatimit të planit. PKV bazuar në aktivitetet e planifikuara, duke përfshirë dhe ndërmarrjen e iniciativave të reja për nxitjen e integrimit të personave të komunitetit LGBTI në Shqipëri, ka marrë në konsideratë fondet e parashikuara nga buxheti i shtetit dhe mundësitë e bashkëfinancimit, duke koordinuar me burime të tjera financimi nga organizata ndërkombëtare apo donatorë.

Plani i Veprimit është hartuar në konsultim me ministritë përgjegjëse të linjës, përfaqësues nga OJF- të e të drejtave të njeriut dhe komunitetit LGBTI, si dhe aktorë të tjerë në nivel qëndror dhe vendor. *Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për personat LGBTI në Shqipëri 2016-2020* jep një panoramë të përgjithshme të gjendjes aktuale të barazisë, mos-diskriminimit dhe të drejtave njerëzore të personave lezbike, gei, biseksualë, trasgjinorë dhe ndërseksualë (LGBTI) në Shqipëri dhe propozon masat për të avancuar më tej të drejtat e njeriut të personave LGBTI në Shqipëri.

Pas marrjes së statusit të vendit kandidat në BE në vitin 2014, qeveria shqiptare ka intensifikuar reformat e nevojshme për aderimin e saj, përfshirë edhe nxitjen e aksesit të barabartë në shërbime dhe të drejtat e barabarta për të gjithë shtetasit. Në këtë kuadër, vëmendje dhe angazhim i veçantë po i kushtohet zbatimit të Rekomandimit të Këshillit të Evropës 2010(5), i cili përcakton mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor (OSIGj-SOGI), për të garantuar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut të personave LGBTI.

Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës CM/Rec (2010)5 për Shtetet anëtare në lidhje me masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të OSIGj është baza parësore për masat dhe rezultatet e propozuara. Tre instrumentet kyçe ndërkombëtare që qëndrojnë në themel të masave të propozuara janë: Udhëzuesi i Shqipërisë për adresimin e 5 prioriteteve kyçe, si pjesë e planit të hyrjes në BE; Raporti Universal i Rishikimit Periodik, i Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut për Shqipërinë i vitit 2014; dhe Raporti i 2015 i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) për Shqipërinë.

Në Planin Kombëtar të Veprimit paraqitet një listë e detajuar e aktiviteteve me afate kohore dhe institucionet përgjegjëse të përcaktuara, të cilat janë parashikuar për t'u zbatuar gjatë periudhës 2016-2020.

Parimet që udhëheqin Planin Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI në Shqipëri janë:

- Respektimi i barazisë dhe anti-diskriminimi Të gjitha aktivitetet e parashikuara në PKV promovojnë të drejtën e personave dhe grupeve të targetuara për të qenë të barabartë dhe mos u diskriminuar për shkak të diversitetit të tyre të orientimit seksual apo identitetit gjinor, në të gjitha fusha e jetës.
- 2. Nxitja e përfshirjes sociale Aktivitetet e PKV-së synojnë të nxisin përfshirjen e personave LGBTI në shoqëri dhe shmangien e krijimit të sistemeve paralele për t'u përdorur nga personat e këtij komuniteti.
- 3. Përmirësimi i aksesit në shërbime Është një nga qëllimet strategjike të PKV, ku një vëmendje e veçantë i kushtohet realizimit të aktiviteteve që synojnë përmirësimin e ndjeshëm të ofrimit të shërbimeve dhe njëkohësisht lehtësimin e aksesit në sektorë të ndryshëm, të tillë si arsimi, shëndetësia, strehimi, punësimi, etj.
- 4. Vënia e theksit mbi angazhimin e komunitetit PKV përcakton mekanizma për angazhimin e komunitetit LGBTI në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike.
- 5. Nxitja e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm Hartimi, zbatimi dhe monitorimi e vlerësimi i PKV-së bazohet në bashkëpunimin midis qeverisë qëndrore, rajonale dhe vendore, shoqërisë civile,komunitetit ndërkombëtar dhe veçanërisht organizata dhe grupime të komunitetit LGBTI.
- 6. Ndërgjegjësimi mbi çështjet e personave LGBTI- PKV merr në konsideratë faktin se në shoqërinë shqiptare ekzistojnë paragjykime dhe diskriminim ndaj personave me orientim të ndryshëm seksual dhe identitet gjinor, duke i kushtuar kësaj çështjeje një vëmendje të veçantë në të gjitha fushat prioritare të parashikuara.
- 7. Promovimi i lidhjeve ndërsektoriale PKV trajton nevojat në një sërë fushash kyçe përfshirë: arsimin dhe promovimin e diversitetit, shëndetësinë, strehimin, punësimin dhe aftësimin profesional, mbrojtjen sociale, garantimin e të drejtave në sistemin e sigurisë dhe drejtësisë, me synim nxitjen e integrimit në mënyrë gjithëpërfshirëse.
- 8. *Matja e progresit* PKV përcakton tregues specifik sasiorë dhe cilësorë për matjen e progresit të zbatimit, si dhe procesin e monitorim/vlerësimit.
- 9. Buxhetimi për zbatimin PKV ka planifikuar një buxhet për zbatimin e çdo aktiviteti. Në rastet kur financimi publik është i pamjaftueshëm, janë identifikuar edhe hendeqet e financimit ku parashikohet kontribute nga donatorët.

II. SITUATA AKTUALE

Që mbas ndryshimeve politike dhe sociale të viteve '90 Shqipëria ka ngritur dhe zhvilluar struktura dhe sisteme në mbështetje të të drejtave të njeriut për qytetarët e saj. Ndonëse është bërë progres në krijimin e kulturës së të drejtave të njeriut dhe barazisë, mekanizmat monitoruese të të drejtave ndërkombëtare të njeriut ofrojnë sugjerime për një përmirësim të mëtejshëm, të referuara edhe në dokumentat e mëposhtme: Rekomandimet e Raportit të Kombeve të Bashkuara për Shqipërinë të Këshillit të të Drejtave të Njeriut, Rishikimin Periodik Universal, 2014, Raportin e ECRI¹ për Shqipërinë 2015, Kapitullin për Shqipërinë të ILGA-Europe, Rainbow Europe, 2015.

Plani Kombëtar i Veprimit për LGBTI-të është një dokument politik i qeverisë shqiptare, në përputhje edhe me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020. Ky Plan do të krijojë sinergji me Ministritë e linjës për mosdiskriminimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Kjo qasje horizontale dhe ndërsektoriale do të sigurojë që të gjithë faktorët të adresohen në mënyrë të barabartë duke maksimizuar përdorimin e burimeve.

Shqipëria është anëtare e Kombeve të Bashkuara (OKB), Këshillit të Evropës (KE), dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), tashmë është edhe vend kandidat i Bashkimit Evropian (BE), dhe të gjitha këto ofrojnë korniza dhe mekanizma mbështetëse për rritjen e respektimit e të drejtave të njeriut, mosdiskriminimit dhe barazisë.

Kultura e barazisë në Shqipëri nuk është shumë e fortë dhe karakterizohet nga një nivel i ulët vlerësimi për çështjet që lidhen me një gamë të gjerë faktorësh, duke përfshirë moshën, gjininë, racën, grupin etnik, aftësinë ndryshe, si edhe orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Gjatë fazës së konsultimit për përgatitjen e PKV-së, u vu re se Shqipëria kërkon të arrijë një zhvillim domethënës, i cili i jep një kuptim më të gjerë kulturës së barazisë, si nga popullata në përgjithësi, ashtu edhe nga administrata dhe ofruesit e shërbimeve.

Barazia, anti-diskriminimi dhe të drejtat e njeriut të personave LGBTI

Ashtu si dhe në eksperiencat ndërkombëtare, situata e personave LGBTI në Shqipëri rezulton të jetë më e mirë në qytete të mëdha dhe veçanërisht në kryeqytet. Ka një tendencë të personave të rinj LGBTI, qëtë zhvendosen drejt qyteteve të vogla dhe të mëdha me qëllim që të gjejnë mbështetje në persona, grupime apokomunitete në situatë të ngjashme, për më shumë siguri, mundësi punësimi, mjedis fizik dhe kulturor më përfshirës.

Pavarësisht se në Shqipëri ka dispozita ligjore, të cilat mbrojnë personat LGBTI nga diskriminimi dhe ndalon gjuhën e urrejtjes në të gjitha fushat, përfshirë dhe edukimin parauniversitar, përvoja tregon se pabarazia dhe mungesa e të kuptuarit të të drejtave të njeriut të personave LGBTI në shoqëri mbizotëron.

Ofruesit e shërbimeve që vendosin edhe kontaktet e para me publikun në fushat e shëndetit, arsimit, zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit, jo gjithnjë e kuptojnë apo vlerësojnë bazën legjislative dhe zbatimin e saj në rastin e personave LGBTI.

Referuar studimit "Perceptimet e punonjësve vendorë mbi shërbimet miqësore ndaj personave LGBTI" (Ambasada PINK, Mars 2016), i pari i këtij llojit në vend, mbi situatën aktuale të perceptimeve të zyrtarëve publikë/vendorë mbi çështjet LGBTI, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe praktikat anti-diskriminim dhe trajtimin e barabartë në 6 qytete të vendit, rezulton se 12.9% e tyre nuk kanë informacion mbi personat LGBT dhe 15.2% kishin marrë informacion prej trajnimeve dhe seminareve, 75.1% deklarojnë se nuk janë trajnuar asnjëherë mbi ketë temë dhe mbi 60% do të donin të trajnoheshin. ¹

Instituti Kombëtar Demokratik po realizon një *Vrojtim për jetën e personave LGBTI*² në rajonin e Ballkanit, duke përfshirë Shqipërinë, i cili do të jetë një burim i dobishëm për Grupin e Koordinimit të Zbatimit Kombëtar dhe punën e PKV-së.

Shqipëria është klasifikuar në vend të 19-të në vitin 2014 dhe 2015 në indeksin Rainbow Europe të ILGA-Europe, që do të thotë se nuk ka pasur përmirësim gjatë dy viteve të fundit. Klasifikimi i vitit 2015 i dha asaj një vlerësim prej 49% pikësh, bazuar në gjendjen e 2014.

Puna e deritanishme

Në kuadër të Rekomandimit CM/Rec (2010)/5 në shtator të vitit 2011,në projektin e Këshillit të Evropës për LGBTI⁴⁶, ku mori pjesë Shqipëria, Letonia, Italia, Mali i Zi, Polonia dhe Serbia, u përgatit Plani Veprimit për mosdiskriminimin në bazë orientimi seksual dhe identiteti gjinor për Shqipërinë 2012-2014.

Sipas indeksit Rainbow Europe 2015 të ILGA-Europe, Shqipëria klasifikohet me 42%. Ky është indeksi i tretë më i lartë në Ballkan, ku Kroacia e ka 71%, Mali i Zi 46% dhe Greqia 39%. Me këtë klasifikim, duket qartë se ka mundësi të bëhet një përparim akoma më i madh.

Ky studim u mbështet nga Bashkimi Evropian në kuadër të iniciativës 'Përmirësimi i jetës së komunitetit LGBT në nivel lokal në Shqipëri' dhe u realizua në bashkëpunim me institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatin e Popullit dhe me mbështetjen e Bashkive të Vlorës, Elbasanit, Tiranës, Korçës, Shkodrës dhe Durrësit.

² www.ndi.org

Arritjet e Planit të Veprimit 2012-2014

Një tipar i veçantë i arritjeve të Plan Veprimit 2012-2014 është forcimi i organizatave LGBTI dhe kontributi që ato japin për përmirësimin e jetës së personave LGBTI në Shqipëri. Konkretisht, arritjet më të rëndësishme të këtij plani përfshijnë:

- Angazhimin me ministritë e linjës, KMD-në, Zyrën e Avokatit të Popullit dhe organizatat ndërkombëtare.
- Ngritjen e çështjeve të LGBTI-ve me donatorë, agjenci, komunitetin ndërkombëtar në Shqipëri dhe në Evropë.
- Ofrimin e trajnimit për punonjësit e policisë dhe punonjësit arsimor.
- Bashkëveprimin dhe bashkëpunimin me OJF të tjera të të drejtave të njeriut.
- Studime mbi kuadrin ligjor.
- Propozime legjislative.
- Raportime për situata diskriminuese dhe ankesa.
- Ndërgjegjësimin e publikut.
- Ofrimin e shërbimeve për komunitetin LGBTI në Shqipëri.
- Ofrimin e strehimit të sigurt në Tiranë për të rinjtë LGBTI që detyrohen të largohen nga shtëpia.

Duhet theksuar se shumë nga veprimtaritë dhe iniciativat e listura më lart janë ndërmarrë dhe realizuar nga shoqëria civile.

Disa reforma legjislative janë realizuar gjatë viteve që nga Rekomandimi, por ka një hendek të madh në zbatim në të gjitha nivelet, dhe sidomos në nivel rajonal dhe vendor ku jeta e përditshme e personave LGBTI në Shqipëri është subjekt diskriminimi.³

Rezoluta e fundit parlamentare

Në 7 maj 2015, Parlamenti Shqiptar miratoi rezolutën "Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të komunitetit LGBTI".

Duke marrë parasysh legjislacionin aktual shqiptar, punën e institucioneve të pavarura dhe raportin e posaçëm të Avokatit të Popullit për personat LGBTI i vitit 2012, Parlamenti Shqiptar:

- Nxit përgatitjen e një Plani Kombëtar Masash për masat e mbrojtjes së të drejtave të personave LGBTI. Ky plan ka nevojë për t'u përgatitur përmes një procesi gjithëpërfshirës, me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve që mbulojnë të drejtat themelore të njeriut;
- Nxit Parlamentin Shqiptar të miratojë amendamentet e nevojshme ligjore, në kuadër të Planit Kombëtar të Masave për mbrojtjen e personave LGBTI (2012-2014), si pjesë e Rekomandimeve (prioriteti 5) për negociatat për anëtarësim në BE;
- Angazhohet për të miratuar Rekomandimet ligjore të Avokatit të Popullit për shtesa dhe ndryshime në Kodin e Punës, në përputhje me Nenin 10 të Direktivës 2000/78 KE, të Komisionit Evropian;
- Nxit të gjitha institucionet shtetërore të zbatojnë Rekomandimin CM/Rec (2010)5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për masat e luftës kundër diskriminimit, bazuar në orientimin seksual ose identitetin gjinor";

Raporti për Projektin LGBTI në Shqipëri, MPÇSMB, 2012; Raport për Plan Veprimin për Mosdiskriminimin në bazë të Orientimit seksual dhe Identitetit gjinor 2012-2014; Reagimi ndaj pyetësorit të Njësisë SOGI, 2014; ILGA-Europe Rainbow Europe 2015.

⁴ http://www.parlament.al/previewdoc.php?file_id=22392

- Nxit Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve për të trajnuar punonjësit e arsimit për një mbrojtje më të mirë të personave LGBTI, me qëllim moslejimin e asnjë lloj diskriminimi, për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, për të organizuar ngjarje kulturore kundër homofobisë dhe transfobisë me institucione arsimore, dhe për të nxitur pjesëmarrjen e organizatave LGBTI dhe anëtarëve të komunitetit në këto aktivitete;
- Nxit Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, përmes Inspektoriatit të Punës, për të kontrolluar zbatimin e dispozitave ligjore nga punëdhënësit, me qëllim garantimin e zbatimit në praktikë të tyre nga punëdhënësit shtetërore apo privatë;
- Nxit Avokatin e Popullit të monitorojë respektimin e të drejtave themelore dhe kushtetuese të njerëzve LGBTI në Shqipëri, si edhe masat që duhen marrë nga institucionet përgjegjëse për respektimin e plotë të tyre;
- Mbështet organizatat e shoqërisë civile në përpjekjet e tyre për rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe nxit Qeverinë Shqiptare të bashkëpunojë me OJF-të e LGBTI-ve në luftën kundër diskriminimit.

Udhërrëfyesi për anëtarësimin në BE

Prioriteti 5 "Përforcimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, përfshirë romët dhe politikat antidiskriminim, si dhe zbatimin e të drejtave pronësore", përmban masa për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të KMD-së; botimin e materialeve informuese; riformulimin e Kodit Penal për sa i takon gjuhës së urrejtjes, diskriminimit; amendamente në Kodin e Familjes; organizimin e trajnimeve për Ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi"; rritjen e ndërgjegjësimit publik për mbrojtjen nga diskriminimi dhe rolin e KMD-së në këtë drejtim; përfshirjen e koncepteve të identitetit gjinor dhe orientimit seksual në Kodet e Familjes dhe të Punës. ⁵

III. METODOLOGJIA

Plani Kombëtar i Veprimit 2016-2020 është hartuar përmes një procesi konsultimi, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile dhe komuniteti ndërkombëtar.

PKV është përgatitur duke përdorur një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut ndaj ndryshimit social. Kjo përfshin konsultime, përdorimin e kuadrit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, zhvillimin dhe zbatimin me pjesëmarrje.

Matrica e PKV përshkruan qëllimet, objektivat dhe aktivitetet, afatet e zbatimit, autoritetet përgjegjese për zbatim dhe kontroll, vlerat e treguesve, burimet e informimit, si dhe fondet e nevojshme për zbatimin e Planit të Veprimit. Matrica është ndarë në tre prioritete, specifikisht:

- 1. Korniza ligjore dhe institucionale
- 2. Mbrojtja nga diskriminimi dhe siguria
- 3. Aksesi në shërbime

Metodologjia e ndjekur për përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit është bazuar në:

- Identifikimin e nevojave të personave/komunitetit LGBTI nëpërmjet një analize paraprake të situatës, bazuar në përvojën dhe arritjet e Planit të Veprimit të mëparshëm 2012-2014, por gjithashtu edhe në mundësitë e burimeve dhe kapacitetet e qeverisë për t'iu përgjigjur këtyre masave.
- Organizimi i takimeve konsultuese nga MMSR me organizatat e shoqërisë civile, duke përfshirë OJF-të e LGBTI-ve dhe OJF-të të drejtave të njeriut, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfaqësues nga komuniteti ndërkombëtar, përfshirë donatorët, AP, KMD dhe Ministritë e linjës.
- Një workshop i përbashkët midis përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe ministrive të linjës është organizuar gjithashtu, për të diskutuar dhe komentuar draftin e parë të PKV-së.
- Propozime konkrete të dala nga workshopi lidhur me reformat kyçe legjislative që nevojiten të bëhen, boshllëqet ekzistuese në zbatimin e ligjit si dhe institucionet kyçe, strategjitë dhe personelin që duhen të angazhohen dhe/ose synohen si pjesë e çuarjes përpara të barazisë dhe cilësisë së jetës për personat LGBTI në Shqipëri si dhe mbi veprime dhe aktivitete specifike, janë reflektuar në këtë dokument.⁶

Matrica e PKV-së përbën në këtë mënyrë një kuadër për veprim për një periudhë pesëvjeçare, e cila lejon përgatitjen e planeve vjetore të zbatimit, bazuar në përparësitë e çdo reforme legjislative, siguron koherencë dhe konsistencë në gjithë politikën e qeverisë dhe ofrimin e shërbimeve, trajnim dhe aftësimin e ofruesve të shërbimit dhe krijimin e një kulture të përfshirjes, barazisë dhe të drejtave të njeriut tek popullata e përgjithshme.

Rekomandimet e Planit të Masave të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor 2015-2020.Qershor 2015. Amarildo Fecanji. Canada Funds for Local Initiatives.

IV. VIZIONI DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Vizioni: Një shoqëri që lufton kundër të gjitha formave të diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor dhe që siguron garantimin e të drejtave të barabarta, duke rritur aksesin në arsim, punësim, shëndetësi, strehim dhe integrim të plotë të personave LGBTI në shoqëri.

Qëllimet Strategjike:

- 1. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe rritja e ndërgjegjësimit për mosdiskriminimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- 2. Eliminimi i të gjithë formave të diskriminimit ndaj komunitetit LGBTI
- 3. Përmirësimi i aksesit në shërbimet e punësimit, edukimit, shëndetësisë, strehimit dhe sporteve për personat LGBTI, duke garantuar mundësi dhe të drejta të barabarta.

Objektivat e politikës

Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI 2016-2020 vjen si një dokument politik i qeverisë shqiptare, i cili adreson problematikat dhe çështjet kryesore që ndikojnë në jetën e personave LGBTI duke krijuar pabarazi dhe diskriminim.

Plani Kombëtar i Veprimit për LGBTI-të është në përputhje edhe me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020. Ky Plan do të krijojë sinergji me Ministritë e linjës për mosdiskriminimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Kjo qasje horizontale dhe ndërsektoriale do të sigurojë që të gjithë faktorët të adresohen në mënyrë të barabartë duke maksimizuar përdorimin e burimeve.

Shqipëria si anëtare e Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, dhe tashmë edhe vend kandidat i Bashkimit Evropian, ka obligimin të ofrojë korniza dhe mekanizma mbështetëse për rritjen e respektimit të të drejtave të njeriut, mosdiskriminimit dhe barazisë.

Ky Plan Veprimi bazohet gjithashtu në arritjet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i Planit të Veprimit 2012-2014, i cili rezulton se ka mundur të realizojë disa reforma legjislative, por evidenton në të njëjtën kohë një hendek të madh në zbatim në të gjitha nivelet, dhe sidomos në nivel rajonal dhe lokal ku jeta e përditshme e personave LGBTI në Shqipëri vazhdon të jetë subjekt diskriminimi.

Për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të PKV-së janë parashikuar ndërhyrje në disa nivele duke përfshirë zhvillime legjislative, politika, përafrimin me politika dhe strategji të tjera të përfshirjes, programimin dhe ofrimin e shërbimeve të standardizuara, trajnimin e stafeve profesionale dhe ofruesve të shërbimeve, si dhe të aktorëve që merren me edukimin/informimin dhe ndërgjegjësimin publik, me një fokus të veçantë tek OJF-të e LGBTI-ve dhe të të drejtave të njeriut.

Aktorët kryesorë të përfshirë në zbatimin e PKV-së janë MMSR, Administrata Publike dhe stafet

përgjegjëse të ministrive të linjës, në nivele kombëtare dhe rajonale; KMD-ja dhe Zyra e Avokatit të Popullit; parlamentarët; profesionistët e fushave të arsimit, shëndetësisë, rinisë, shërbimeve sociale, punësimit; OJF Kombëtare dhe Ndërkombëtare të LGBTI-ve dhe të të Drejtave të Njeriut; ekspertë të vendit dhe ndërkombëtarë.

Fushat e prioritare dhe objektivat specifike të PKV 2016-2020 janë mbështetur në nevojat e adresuara nga vetë komuniteti LGBTI si dhe analiza e boshllqëve dhe mosrealizimeve të PKV 2012-2014.

Fusha e politikës (1): Korniza ligjore dhe institucionale

Objektivi 1.1: Të krijohet Grupi Kombëtar i Zbatimit dhe Koordinimit (GKZK) për të monitoruar zbatimin e ecurisë së PKV 2016-2020.

Objektivi 1.2: Të identifikohen boshllëqet në legjislacion për të garantuar mosdiskriminim dhe të drejtat e personave LGBTI.

Objektivi 1.3: Të rritet ndërgjegjësimi i punonjësve civilë mbi të drejtat e komunitetit LGBTI dhe mbrojtjen e tyre ligjore.

Objektivi 1.4: Të fuqizohet shoqëria civile në mbrojtje të të drejtave të komunitetit LGBTI.

Fusha e politikës (2): Mbrojtja nga diskriminimi dhe siguria

Objektivi 2.1: Të krijohet një sistem të dhënash statistikore dhe raportimi lehtësisht të aksesueshme mbi rastet e diskriminimit në fushat përkatëse.

Objektivi 2.2: Të garantohet mbrojtja e personave LGBTI nga diskriminimi dhe dhuna për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve në sektorët e drejtësisë dhe sigurisë.

Objektivi 2.3.Të parandalohet gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor nëpërmjet ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe fuqizimit të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të LGBTI.

Objektivi 2.4: Të garantohet siguria dhe dinjiteti në institucione nëpërmjet kualifikimit të punonjësve dhe hartimit të protokolleve të punës jodiskriminuese.

Fusha e politikës (3): Aksesi në shërbime

Objektivi 3.1: Të përmirësohet situata e punësimit për personat LGBTI nëpërmjet informimit dhe ndërgjegjësimit të punëdhënësve dhe ofrimit të programeve lehtësuese për punësim.

Objektivi 3.2: Të reduktohet diskriminimi mbi LGBTI në arsim nëpërmjet rishikimit të kurrikulave në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit të punonjësve arsimorë.

Objektivi 3:3 Të përmirësohet aksesi dhe ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor nëpërmjet përfshirjes të çështjeve LGBTI në programet parandaluese dhe ngritjes së kapaciteteve të punonjësve të shëndetësisë.

Objektivi 3.4: Të përmirësohet situata e strehimit të personave LGBTI nëpërmjet krijimit të programeve lehtësuese të strehimit dhe shërbimeve të standardizuara të strehimit të sigurt.

Objektivi 3.5: Të përmirësohet aksesi i personave LGBTI në ambientet sportive komunitare duke reduktuar diskrimimin.

Objektivi 3.6: Të përmirësohet legjislacioni dhe politikat përfshirëse të azilit për personat LGBTI.

V. OBJEKTIVAT SPECIFIKE DHE PRODUKTET MADHORE

Në bazë të vlerësimit të situatës aktuale të personave LGBTI në Shqipëri, propozohet një model dinamik ndryshimi, i cili përfshin masa për legjislacionin, politikën sociale, administratën publike dhe shërbimet, me qëllim për të krijuar një kulturë përfshirjeje dhe hapjeje ndaj diversitetit dhe për forcimin e komunitetit të LGBTI-ve.

Në këtë plan janë identifikuar disa fusha prioritare ndërhyrjeje dhe ndryshimesh të ndërlidhura, të cilat synojnë të garantojnë respekt më të madh për të drejtat e personave LGBTI në Shqipëri, mosdiskriminim dhe barazi në të gjitha aspektet e jetës së përditshme. Plani i aktiviteteve të parashikuara sipas qëllimeve strategjike dhe objektivave specifike, afateve të përcaktuara kohore, buxheteve të parashikuara dhe përgjegjësive të institucioneve përkatëse synon të arrijë rezultate realiste në çdo fushë.

Aktivitete të parashikuara janë identifikuar si rezultat i një procesi konsultimesh me shoqërinë civile, institucionet ligjore dhe ministritë e linjës.

Objektivi 1.1: Të krijohet Grupi Kombëtar i Zbatimit dhe Koordinimit (GKZK) për të monitoruar zbatimin e ecurisë së PKV-së 2016-2020.

Rezultatet e pritshme:

 Krijimi i GKZK i përbërë nga përfaqësues të MMSR dhe ministrive të linjës si dhe përfaqësues të organizatave LGBTI, i cili do të koordinojë dhe monitorojë zbatimin hap pas hapi të PKV-së.

Objektivi 1.2: Të identifikohen boshllëqet në legjislacion për të garantuar mosdiskriminim dhe të drejtat e personave LGBTI.

Rezultatet e pritshme:

- Një analizë komplekse vlerësuese mbi legjislacionin ekzistues dhe një paketë rekomandimesh lidhur me boshllëqet e kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe mosdiskriminimit.
- Ndryshime në kode dhe ligje specifike për të garantuar më shumë të drejta për personat LGBTI.
- Masa të reja ligjore ndaluese ndaj diskriminimit për shkak të OSIGj.

Objektivi 1.3: Të rritet ndërgjegjësimi i punonjësve civilë mbi të drejtat e komunitetit LGBTI dhe mbrojtjen e tyre ligjore.

Rezultatet e pritshme:

- Ndërgjegjësimi i punonjësve civil në nivel rajonal dhe lokal mbi mbrojtjen ligjore dhe të drejtat e LGBTI.
- Informim dhe ndërgjegjësim i prokurorëve dhe avokatëve mbi mbrojtjen ligjore dhe të drejtat e LGBTI.
- Rritja e mbrojtjes ligjore me një gjyqësor dhe profesionistë të mirëinformuar dhe të trajnuar.
- Penalitete të përcaktura dhe të përshatshme për rastet e diskriminimit ndaj personave LGBTI.

Objektivi 1.4: Të fuqizohet shoqëria civile në mbrojtje të të drejtave të komunitetit LGBTI. Rezultatet e pritshme:

- Fuqizimi i OJF-ve dhe grupimeve në mbrojtje të LGBTI me prioritet zonat me mungesë shërbimesh.
- Forcimi i bashkëpunimit të organizatave të komunitetit LGBTI dhe i ofrimit të shërbimeve për personat LGBTI në mbarë Shqipërinë.
- Përfshirje më e madhe e OJF-ve në mbrojtje të të drejtave të LGBTI.

Objektivi 2.1: Të krijohet një sistem të dhënash statistikore dhe raportimi lehtësisht të aksesueshme mbi rastet e diskriminimit në fushat përkatëse.

Rezultatet e pritshme:

- Formate të reja për regjistrimin dhe raportimin e incidenteve te diskriminimit në punë, ofrimin e shërbimeve dhe të mirave si dhe të dhëna statistikore.
- Formate të reja për regjistrimin dhe raportimin e rasteve të personave të pastrehë për shkak të OSIGj dhe të dhëna statistikore.

Objektivi 2.2: Të garantohet mbrojtja e personave LGBTI nga diskriminimi dhe dhuna për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve në sektorët e drejtësisë dhe sigurisë.

Rezultatet e pritshme:

- Krijimi i një strukture të posaçme mbështetëse në DPPSH dhe strukturat rajonale për të mbrojtur viktimat nga diskriminimi, gjuha e urrejtjes dhe krimet e motivuara nga paragjykimi.
- Rregullore dhe procedura të mirpërcaktuara trajtimi të krimeve të motivuara nga paragjykimi për strukturat e policisë.
- Protokolle dhe paketa udhëzuese mbi krimet e motivuara nga paragjykimet për punonjësit e policisë, avokatët, prokurorët dhe gjykatësit.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe aftësive të punonjësve të policisë në nivel rajonal dhe vendor mbi mbrojtjen nga diskriminimi i personave LGBTI.
- Rritja e ndërgjegjësimit të strukturave të policisë në nivel rajonal dhe vendor për të garantuar raportimin pa frikë.
- Një panoramë më e qartë e eksperiencave dhe formave të krimeve të motivuara nga paragjykimi.
- Përmirësimi i kapaciteteve të policisë, gjykatave dhe personelit të IEVP-ve mbi procedurat për identifikimin dhe trajtimin e krimeve të motivuara nga paragjykimi.

Objektivi 2.3.Të parandalohet gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi për shkak të OSIGj nëpërmjet ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe fuqizimit të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të LGBTI. Rezultatet e pritshme:

- Ngritja e një sistemi funksional raportimi për të parandaluar gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin.
- Rritja e ndërgjegjësimit publik mbi gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin ndaj personave LGBTI.
- Rritja e kulturës së përfshirjes dhe diversitetit në shoqërinë Shqiptare.
- Përforcimi dhe zbatimi i sanksioneve për të parandaluar gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin.
- Ofrimi i mbështetjes së viktimave të krimeve të motivuara nga paragjykimi nëpërmjet krijimit të linjës telefonike.

Objektivi 2.4: Të garantohet siguria dhe dinjiteti në institucione nëpërmjet kualifikimit të punonjësve dhe hartimit të protokolleve të punës jodiskriminuese.

Rezultatet e pritshme:

 Ngritja e kapaciteteve të personelit të IEVP-ve për ofrimin e një shërbimi cilësor dhe të standardizuar për personat LGBTI.

Objektivi 3.1: Të përmirësohet situata e punësimit për personat LGBTI nëpërmjet informimit dhe ndërgjegjësimit të punëdhënësve dhe ofrimit të programeve lehtësuese për punësim. Rezultatet e pritshme:

 Ndërgjegjësimi i punëdhënsve mbi përgjegjësitë, të drejta dhe dispozitat ligjore për personat LGBTI.

- Ndërgjegjësimi i personave LGBTI mbi të drejtat e punonjësve, ankesat dhe format e dëmshpërblimit.
- Rritja e kapaciteteve profesionale të personave LGBTI për një integrim më të mirë në tregun e punës.
- Ofrimi i një shërbimi më të përshtatshëm dhe efektiv në ZP për personat LGBTI.
- Krijimi i sipërmarrjeve dhe bizneseve sociale për fuqizimin ekonomik të personave LGBTI.

Objektivi 3.2: Të reduktohet diskriminimi mbi LGBTI në arsim nëpërmjet rishikimit të kurrikulave në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit të punonjësve arsimorë mbi LGBTI.

Rezultatet e pritshme:

- Rishikimi dhe përshtatja e kurrikulave dhe teksteve shkollore në të gjitha nivelet e arsimit për reduktimin e diskriminimit të personave LGBTI.
- Ndërgjegjësimi dhe rritja e kapaciteteve të punonjësve arsimorë mbi çështjet LGBTI.
- Garantimi i mbrojtjes së të drejtave në institucionet arsimore në nivel kombetar.

Objektivi 3.3: Të përmirësohet aksesi dhe ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor nëpërmjet përfshirjes së çështjeve LGBTI në programet parandaluese dhe ngritjes së kapaciteteve të punonjësve të shëndetësisë.

Rezultatet e pritshme:

- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore të përshtatshme, të sigurta, miqësore dhe jodiskriminuese në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor.
- Përfshirja e çështjeve LGBTI në programet parandaluese dhe strategjitë e kujdesit shëndetësor.
- Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të shëndetësisë mbi çështjet e identitetit gjinor dhe interseksit.

Objektivi 3.4: Të përmirësohet situata e strehimit të personave LGBTI nëpërmjet krijimit të programeve lehtësuese të strehimit dhe shërbimeve të standardizuara të strehimit të sigurt. Rezultatet e pritshme:

- Zhvillimi i protokolleve administrative për të siguruar shmangien e diskriminimit dhe përfshirjen e personave LGBTI në programet e strehimit social.
- Rritja e ndërgjegjësimit të ofruesve të programeve sociale të strehimit në nivel qëndror, rajonal dhe vendor.
- Ofrimi i shërbimeve të standartizuara të strehimit të sigurt për personat e pastrehë për arsye të OSIGj.

Objektivi 3.5: Të përmirësohet aksesi i personave LGBTI në ambientet sportive komunitare duke reduktuar diskrimimin.

Rezultatet e pritshme:

- Hartimi i rregulloreve dhe ofrimi i praktikave të mira në federatat e sportit për të reduktuar diskriminimin dhe dhunën në ambientet sportive.
- Rritja e aksesit të organizatave dhe grupeve LGBTI në lehtësirat sportive në nivel komunitar.

Objektivi 3.6: Të përmirësohen legjislacioni dhe politikat përfshirëse të azilit për personat LGBTI. Rezultatet e pritshme:

- Njohja e të drejtës për azil për shkak të OSIGj.
- Krijimi i politikave përfshirëse për azil për personat LGBTI.

VI. BURIMET FINANCIARE

Plani i Veprimit do të zbatohet në periudhën 2016-2020. Për të mbështetur zbatimin e tij është parashikuar buxheti për secilin aktivitet, objektiv specifik dhe qëllim strategjik. Buxheti i përgjithshëm për realizimin e PKV është rreth **306.2 milion lekë** ose afërsisht **2.2 milion Euro**⁷.

Buxheti u hartua mbështetur në koston e secilit aktivitet të pasqyruar në planin e veprimit dhe kohështrirjen e tij. Metodologjia e zbatuar për llogaritjen e kostove paraqet një kombinim të metodave që mund të përdoren në rastet e strategjive ndërsektoriale. Metodologjia kryesore e përdorur është kostimi i bazuar në aktivitete (Activity Based Costing-ABC), metodologji e veçantë kostimi që identifikon aktivitetet në çdo institucion dhe cakton koston e çdo aktiviteti duke alokuar burime për të gjitha produktet dhe shërbimet në bazë të konsumit aktual për aktivitetë. Për llogaritjen e shpenzimeve për aktivitetet kryesore është vepruar si më poshtë:

Llogaritja e shpenzimeve për aktivitete që lidhen me hartimin dhe rishikimin e legjislacionit, monitorimin dhe funksionimin e strukturave të përhershme, etj. Për këto aktivitete gjatë llogaritjeve janë mbajtur parasysh shpenzimet e vazhdueshme që do të ndodhin, për shembull për pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore, ekspertizë të huaj (kur është parashikuar në plan) dhe shpenzime operative.

<u>Llogaritja e shpenzimeve për "aktivitete specifike" ose i iniciativave specifike të ngjashme</u>. Në këto raste kostimi shpesh është i limituar, pra ai përdoret një herë të vetme, siç ndodh në rastin e studimeve, fushatave ndërgjegjësuese, programeve të trainimit, ekspertizës së huaj, etj. Vlerësimi i shpenzimeve për këto aktivitete u bazua kryesisht në natyrën e aktiviteteve dhe kostot që ofron tregu për shërbime të tilla.

Në llogaritjen e shpenzimeve për trainime është mbajtur në konsideratë kosto e trainimit për një person. Si kosto për njësi janë përdorur kostot e ASPAs dhe/ose kostot e aplikuara për trainime të ngjashme në të shkuarën.

Për atë pjesë të aktiviteteve ku informacioni nuk ishte i plotë është ndjekur metoda e vlerësimit për analogji, ose me fjalë të tjera janë marrë në konsideratë shpenzimet e bëra për aktivitete të ngjashme në të shkuarën.


Për të realizuar buxhetimin u konsultua gjithashtu dokumenti i PBA 2016-2018, buxheti për vitin 2016, buxhete për aktivitete të ngjashme të zbatuara nga institucione, donatorë apo organizata jo-fitimprurëse në të shkuarën.

Buxheti i përgjithshëm për zbatimin e PKV është reflektuar në disa forma:

- Buxheti i përgjithshëm sipas viteve për secilin aktivitet, objektiv specifik, qëllim strategjik dhe burimeve të financimit⁹.
- Buxheti i detajuar sipas aktiviteteve, treguesve, burimeve të financimit dhe institucioneve përgjegjëse¹⁰.
- Gjatë llogaritjeve është mbajtur parasysh norma e inflacionit 2%.
- Mbështetur në informacionin e disponueshëm janë identifikuar fondet e angazhura nga buxheti i shtetit dhe fondet që nevojiten për tu siguruar nga donatorë dypalësh dhe shumëpalësh.
- 7 Kursi i këmbimit 1 Euro=138.8 lekë
- 8 Në shtojcën 4.3 janë llogaritjet e kostove për secilin aktivitet.
- 9 Për të dhëna të detajuara shih shtojcën 4.1
- 10 Për të dhëna të detajuara shih shtojcën 4.2

• Buxheti i kërkuar për zbatimin e PKV ka një shtrirje pak a shumë uniforme për periudhën 2017-2020 (fig.2.1).

Figura 1. Buxheti në % për periudhën 2016-2020



- Nga llogaritjet rezulton që buxheti i shtetit me burimet në dispozicion mund të mbulojë 36.7% të kostove së përgjithshme për zbatimin e PKV.
- Tabela 1 paraqet buxhetin e përgjithshëm dhe nevojat për financim për periudhën 2016-2020.
- Tabela 1 paraqet gjithashtu buxhetin e përgjithshëm për secilin objektiv, peshën që ka buxheti i secilit objektiv në kuadër të qëllimit strategjik dhe ndaj buxhetit të përgjithshëm.
- Buxhetin më të madh e kërkon objektivi 1.4 "Të fuqizohet shoqëria civile në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI" me 26.5%.
- Nevojat për fonde për këtë objektiv janë rreth 35.1% e totalit të nevojave për fonde nga donatorët.
 Fondet nevojiten kryesisht për aktivitete që kanë të bëjnë me fuqizimin e organizatave LGBTI, financimin e shërbimeve që jepen nga organizatat, ngritjen e mekanizmave mbështetës dhe studime¹¹.
- Fondet e angazhuara nga donatorët për vitin 2016 janë të papërfillshme në raport me nevojat për financime. Ndërkohë që MMSR po punon për të ngritur fonde nga donatorët për periudhën 2017-2020.

Tabela 1: Buxheti sipas qëllimeve dhe objektivave

Qëllimet Strategjike/objektivat	Totali në Lekë	Në % brenda qëllimit strategjik	Në % ndaj totalit	Nevoja për Fonde (në lekë)	Nevoja për Fonde në % brenda QS
Qëllimi strategjik 1: Përmirësimi i kornizës ligjore بـ	er mbrojtjen e të	drejtave të perso.	nave LGBTI		
Objektivi 1.1. Të krijohet Grupi Kombëtar i Zbatimit dhe Koordinimit	3,383,788.18	3.6%	1.1%	0.00	0.0%
Objektivi 1.2: Të identifikojë boshllëqet në mbrojtjen ligjore dhe legjislacion	3,446,787.09	3.7%	1.1%	3,019,990.00	4.2%
Objektivi 1.3: Rritja e ndërgjegjësimit të punonjësve civilë mbi mbrojtjen ligjore dhe të drejtat	5,670,326.50	6.1%	1.9%	1,668,241.20	2.3%
Objektivi 1.4: Të fuqizohet shoqëria civile në mbrojtje e të drejtave të komunitetit LGBTI	81,023,400.83	86.6%	26.5%	68,001,264.66	93.6%
Totali-Qëllimi Strategjik 1	93,524,302.59	100.0%	30.5%	72,689,495.86	100.0%
Qëllimi Strategjik 2: Eliminimi i të gjithë formave të	diskriminimit nda	aj komunitetit LGI	371		
Objektivi 2.1: Të krijohet një sistem të dhënash					
statistikore dhe raportimi mbi rastet e diskriminimit në					
fushat përkatëse	1 500 710 80	4.70/	0.50/	0.00	0.000/
Objektivi 2.2: Të mbrohen personat LGBTI nga	1,538,712.68	1.7%	0.5%	0.00	0.00%
diskriminimi dhe dhuna	54,622,133.90	61.8%	17.8%	35,113,245.21	57.84%
Objektivi 2.3: Të parandalohet gjuha e urrejtjes dhe					
diskriminimi	27,731,458.83	31.4%	9.1%	21,357,432.40	35.18%
Objektivi 2.4 Të garantohet siguria dhe dinjiteti në					
institucione Totali-Qëllimi Strategjik 2	4,450,739.45 88,343,044.85	5.0%	1.5%	4,231,922.95 60,702,600.55	6.97% 100.0%
		100.0%	28.9%	60,702,600.55	100.0%
Qëllimi strategjik 3: Përmirësimi i aksesit në shërb.	me				
Objektivi 3.1: Të përmirësohet situata e punësimit për		270077 7500		A 0111 SACT AT AMOUNT HOU	
personat LGBTI	54,510,525.53	43.8%	17.8%	20,190,337.02	33.5%
Objektivi 3.2: Të reduktohet diskriminimi mbi LGTBI	17 014 077 05	40.00/	E 00/	0.000.050.00	10.50/
në arsim Objektivi 3.3: Të përmirësohet aksesi dhe ofrimi i	17,214,977.85	13.8%	5.6%	9,932,250.00	16.5%
shërbimeve shëndetësore	23,474,832.29	18.9%	7.7%	11,204,300.00	18.6%
Objektivi 3.4 Të përmirësohet situata e strehimit të	20,919,002.20	10.370	1.170	11,204,000.00	10.070
personave LGBTI	17,725,670.25	14.3%	5.8%	12,810,387.50	21.2%
Objektivi 3.5 Të përmirësohet aksesi i personave					
LGBTI në sporte duke reduktuar diskrimimin	10,790,869.47	8.7%	3.5%	5,706,618.08	9.5%
Objektivi 3.6 Të përmirësohen legjislacioni dhe	ACCUSTO AND	5128HW7700	14 1500 TO 000-00		(T) (Taranta)
politikat përfshirëse të azilit për personat LGBTI	623,705.00	0.5%	0.2%	499,905.00	0.8%
Totali-Qëllimi Strategjik 3	124,340,580.40	100.0%	40.6%	60,343,797.60	100.0%
Totali-Plani Veprimit (Lekë)	306,207,927.84		100.0%	193,735,894.02	63.3%
Totali Plani Veprimit (Euro)	2,206,108.99			1,395,791.74	

VII. LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI 2016-2020, është një dokument politikash specifike për komunitetet e targetuara, në përputhje të plotë me të gjitha strategjitë sektoriale dhe nën ombrellën e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI). Në këtë kontekst procesi i monitorimit të zbatimit të tij do të jetë një proces ndërsektorial.

Kuadri vlerësues dhe monitorues do të ushqejë orientimin e politikave në kuader të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) i cili është sistemi kryesor vendimmarrës që përcakton drejtimin strategjik dhe alokimin e burimeve të vendit. Ai do të furnizojë me raporte monitoruese dhe vlerësuese Grupin e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), për Sektorin e Punësimit dhe atë Social, i ngritur me Urdhërin e Kryeministrit Nr.129 datë 21.09.2015 "Për marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP). GMIPtë do të monitorojnë reformat sektoriale në Shqipëri në përputhje me Prioritetet e Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), procesin e anëtarësimit në BE dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë. Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të këtij Plani do të paraqitet në mënyrë periodike dhe do të jetë pjesë e diskutimeve në takimet e Nëngrupit Tematik të Përfshirjes Sociale që do të udhëhiqet nga MMSR dhe përberje të strukturave ndërsektoriale.

Në nivel më bazik për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit, përgjegjëse do të jenë Pikat Fokale për barazinë gjinore në ministritë e linjës, të cilët mbledhin të dhëna dhe identifikojnë boshllëqet e informacionit që nevojitet. MMSR ka rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit. PKV parashikon publikimin e progres raporteve vjetore dhe mbështetjen për raportet monitoruese të shoqërisë civile. Sfida për një funksionim më të plotë të kuadrit monitorues mbetet ndërveprimi me strukturat e nivelit vendor.

Ministritë përgjegjëse do të punojnë me përfaqësuesit rajonal dhe vendor për të përmirësuar cilësinë e të dhënave. Të dhënat administrative do të përdoren nga pjesa më e madhe e ministrive për të monitoruar pjesëmarrjen e personave LGBTI në programet e përgjithshme dhe të synuara të qeverisë, siç janë promovimi i punësimit, programet e strehimit, etj.

Një vëmendje e veçantë në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të PKV^{se} do t'i kushtohet ngritjes së kapaciteteve të punonjësve të istitucioneve përgjegjëse në nivel qëndror dhe vendor për të garantuar mbledhjen e të dhënat të nevojshme duke mbrojtur njëkohësisht të drejtat e privatësisë të personave LGBTI.

Në nivel politikash dhe objektivash strategjike, monitorimi do të kryhet përmes mekanizmit të vlerësimit bazuar në rezultate, sipas urdhërit nr. 139, datë 1.7.2010, të kryeministrit, "Për zbatimin e procesit të monitorimit të Strategjive Sektoriale e Ndërsektoriale".

MMSR ka një rol koordinues në zbatimin dhe monitorimin e PKV^{së}, nëpërmjet Drejtorisësë Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, e cila në bashkëpunim të ngushtë me Grupin Kombëtar të Zbatimit dhe Koordinimit *(GKZK)* do të krijojë një cikël monitorimi dhe vlerësimi sipas afateve të përcaktuara, monitorojë zbatimin e PKV^{së}dhe do të hartojë raportet e progresit.

Gjithashtu MMSR do të koordinojë procesin e mbledhjes së të dhënave nga të gjitha Pikat Fokale për barazinë gjinore në Ministritë e linjës, sipas sektorëve që ato mbulojnë, si edhe NJQV në funksion të monitorimit dhe vlerësimit të arritjes së objektivave të PKV^{se}. Njëkohësisht, MMSR do të lehtësojë koordinimin me organizatat ndërkombëtare, të cilat adresojnëçështjet e personave LGBTI përmes programeve të tyre.

Cikli i monitorimit dhe vlerësimit do të përfshijë:

- Vlerësimin formues të progresit dhe rishikimin e veprimeve të parashikuara në mes të afatit, në periudhën 2016-2020.
- Pas vlerësimit formues të progresit, MMSR do të bëjë rishikimin dhe përditësimin e masave të PKV^{së} për personat LGBTI, duke patur parasysh edhe planifikimet buxhetore deri në vitin 2020.
- Një vlerësim përfundimtar që do të bëhet në fund të 2020, ku do të përcaktohet çdo çështje e pazgjidhur dhe zhvillime që mbeten për t'u realizuar.

Baza kryesore e kuadrit monitorues të Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI 2016-2020, do të jetë lista e Treguesve të Monitorimit sipas tabeles në Aneksin 2.

Roli i shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar në zbatimin e planit të veprimit

Plani i Veprimit identifikon organet shtetërore që janë përgjegjëse për zbatimin e secilit prej aktiviteteve, por një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve luajnë edhe grupet e tjera të interesit, të cilat lidhin institucionet me komunitetin LGBTI, si dhe financojnë ndërhyrjet e synuara për përmirësimin e situatës dhe mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI. Organizatat LGBTI si dhe OJF-të e të drejtave të njeriut janë identifikuar veçanërisht si partnerë kyç për realizimin e objektivave të PKV-se. Gjatë periudhës në vijim, qeveria do të vazhdojë të mbështetet në ndihmën për ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve sociale, të kujdesit shëndetësor dhe të arsimimit, plotësimin e nevojave për strehim të sigurt, punësim dhe bashkëpunimin në fusha të tjera.

Komuniteti ndërkombëtar do të kontribuojë gjithashtu në zbatimin e PKV^{së} duke promovuar shembujt e praktikës së mirë nga Shqipëria dhe Rajoni, si dhe duke bashkëfinancuar disa prej aktiviteteve. Për të lehtësuar këtë proces, qeveria ka identifikuar aktivitete specifike të PKV^{së} që do të përmirësonin situatën e të drejtave dhe mbrojtjen e personave LGBTI.

Roli i njësive të qeverisjes vendore (NJQV) në zbatimin e PKV^{së}

NJQV^{+te} do të gjenerojnë burime dhe kapacitete të rëndësishme për zbatimin e aktiviteteve të mbrojtjes së të drejtave të personave LGBTI. Nga ana tjetër, vetë bashkitë mund të zgjedhin që të hartojnë Plane Lokale Veprimi per Përfshirjen Sociale ose Mbrojtjen Sociale, ku mbrojtja e të drejtave të komunitetit LGBTI, të jetë një ndër objektivat kryesore.

Gjithashtu, NJQV^{te} luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e masave të Planit Kombëtar të Veprimit në të gjithë sektorët. Në sajë të rritjes së përgjegjësive të pushtetit vendor bazuar në reformat e Decentralizimit, dhe Administrimit Territorial, ministritë parashikojnë një bashkëpunim më të ngushtë me NJQV^{te} për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit dhe mbledhjen e të dhënave për monitorim vlerësimin e PKV-së.

VIII. BIBLIOGRAFIA

- 1. Raport për Projektin LGBTI në Shqipëri, MPÇSMB, 2012.
- 2. Raport për Plan Veprimin për mosdiskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe Identitetit gjinor 2012-2014.
- 3. Këshilli i Evropës Pyetsori CDDH i Komitetit Drejtues për të Drejtat e Njeriut dhe Raporti për zbatimin e Rekomandimit 2010/5 (Mars 2013).
- 4. ILGA-Europe Rainbow Digest, Kapitulli për Shqipërinë, 2015.
- 5. Raporti i ECRI-t për Shqipërinë, qershor 2015.
- 6. Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Raporti i UPR për Shqipërinë, 2014.
